


TË DREJTA



PËR TË GJITHË

DEMOKRACIA - ZHVILLIMI NDËR VITE


ADEA (12), ALMA (12), BERIN (12), DIAMANT (13), ENEA (11), FLANDËR (12), OLSA (11), RINOR B. (12), RINOR K. (13)



Në vende të ndryshme të botës, demokracia është akoma në nivel të ulët, por ne si e ardhmja e botës moderne, do të mundohemi që ta bëjmë botën një vend më të mirë për jetë

Demokracia filloi në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Atëherë, demokracia ishte jo shumë e zhvilluar me pabarazi sociale dhe gjinore. Tani, barazia sociale dhe gjinore është më e përparuar në demokracinë moderne. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët „demos“ dhe „kratia“ që do të thotë popull dhe udhëheqje. Elementet e demokracisë janë: liria, barazia, respekti, të drejtat themelore të njeriut, etj. Me liri nënkuptojmë lirinë e shprehjes, lirinë e veprimit, lirinë për të zgjedhur, etj. Me barazi nënkuptojmë barazi gjinore, barazi fetare, barazi sociale, etj. Të drejtat themelore janë e drejta e jetës, e drejta e familjes, e drejta e lojës, e drejta e arsimimit, e drejta e votës, e drejta e ushqimit, e drejta e emrit, e drejta e punës etj. Që nga viti

2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur, demokracia e saj u forcua edhe më shumë. Demokracia në Kosovë është demokraci parlamentare. Para shumë viteve në Kosovë, demokracia nuk ka qenë shumë e zhvilluar. Kishte pabarazi gjinore, pabarazi sociale, edhe shumë njerëz nuk mund të gëzonin të drejtat e tyre. Sot ne e kemi Qeverinë, Kuvendin dhe shumë institucione të tjera. Çdo ditë e më shumë, populli i Kosovës lufton për demokraci më të zhvilluar.



Duke punuar artikullin



Autorët e këtij artikulli

ZGJEDHJET NË KOSOVË

ENISA (12), ALBERT (13), HEKTOR (11), ANISA (12), LAURIT (12), MELOS (12), ERAR (12), ARTIOLA (11), ADISA (12)

Ne sot mësuam për zgjedhjet dhe demokracinë

Sot mësuam se të gjithë kemi të drejtën e votës pa dallim race, feje, gjinie, etj. Zgjedhjet janë element i demokracisë, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë pushtet. Ne kemi të drejtën e votës që nga moshë 18 vjeçare. Vota është sekrete për arsye të ruajtjes dhe besimit të saj. Nuk kemi të drejtë të votojmë dy herë. Po ashtu, nuk kemi të drejtë t’ia imponojmë votën dikujt. Të gjitha votat duhet të numërohen. Edhe të burgosurit kanë të drejtën e votës. Përmes zgjedhjeve i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Në votim duhet t’i zgjedhim personat e duhur që do ta përfaqësojnë vendin tonë. Ne duhet të jemi të sigurtë se kë do të votojmë. Ne jemi pro demokracisë për një të ardhme edhe më të mirë.



Autorët e artikullit



Liria e të shprehurit



Çka dijmë ne për zgjedhjet



Të drejtat tona



Duke votuar

FUQIA E POPULLIT

ERËZA (11), ERIS (12), KLEA (12), DARDANI (12), ANISA (12), UJËVARË (13), ELSA (12), BLENDI (12),
ELONA (12)



Ne sot mësuam se demokracia është baza e lirisë dhe se qytetarët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e mëtufjeshëm të saj

Demokracia është një formë qeverisjeje në të cilën të gjithë qytetarët bëjnë pjesë. Demokracia interpretohet në disa institucione të ndryshme si Kuvendi dhe Qeveria. Demokracia në kohët e më hershme nuk ishte në nivel, sepse kishte dallime të mëdha në mes të racave, kombëve, gjuhëve. Mund të thuhet se deri në vitet 97-98 nuk kishte demokraci në vendin tim.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti, ajo na garanton të gjitha të drejtat si qytetarë të atij vendi. Ne si shtetas të Kosovës kemi të garantuara liritë dhe të drejtat tona. Fuqia vendimmarrëse është në favor të qytetarëve. Ndërsa Kuvendi është vendi ku merren vendimet, dhe miratohen ligjet.

Ne si qytetarë kemi obligime ndaj shtetit dhe ndaj njëri tjetrit. Komunitetet janë grupe njerëzish të cilët jetojnë në një vend të përbashkët dhe flasin të njëjtën gjuhë. Ne si qytetarë kemi të drejtën e të folurit, lëvizjes, pjesëmarrjes, punës, etj. Duke u bazuar në këto të drejta ne kemi përgjegjësi që duhet kryer me kujdes. Duke i analizuar të gjitha këto me kujdes, i bie që ne të jemi pjesë e qytetarisë aktive.

Disa detyra dhe përgjegjësi që i kemi në shtëpi, shkollë, lagje dhe në shtet janë: të respektojmë prindërit, të kujdesemi për të tjerët, të bëjmë detyrat e shtëpisë, të mos hedhim mbeturina, të pastrojmë shtëpinë, të mbledhemi të gjithë për t'a pastruar lagjen, të marrim pjesë në aktivitete shtetërore si zgjedhjet, grupimet e popullit, etj. Ne jemi e ardhmja e Kosovës, prandaj veprimet tona ndikojnë në shtetin tonë.




Gazetarët gjatë punës



E ardhmja në duart e gazetarëve

KUVENDI I KOSOVËS

ANITA (12), ANESA (12), DORINA (11), ERBLINI (12), ORGESA (12), RRON (12), YLLKA (12), FESTINA (12)



Kuvendi është „Shtëpia e Popullit“

Ne si fëmijë e kemi mësuar se çdo vend demokratik ka edhe institucione demokratike. Edhe vendi jonë si vend demokratik i ka këto institucione, e një ndër to është Parlamenti. Fjala parlament rrjedh nga fjala latine „parle“ që do të thotë të flasësh, ku e tërë kjo na bënë të kuptojmë se Parlamenti ose Kuvendi është zëri i popullit. Kuvendi është institucion demokratik dhe ka disa funksione kryesore. Si organ legjislativ që është, bën miratimin e ligjeve, mbikëqyr Qeverinë, përfaqëson popullin, si dhe miraton buxhetin e Republikës së Kosovës. Kuvendi është i përfaqësuar nga 120 deputetë, ku 100 prej tyre zgjedhen direkt nga ana e popullit, ndërsa 20 të tjerët janë të garantuara nga komunitetet jo shumicë, po ashtu që zgjedhen nga populli. Këtë numër të deputetëve e përbëjnë pozita dhe

opozita. Siç edhe e dijmë, pozita përbën numrin më të madh të deputetëve dhe ka ulëse më shumë, ndërsa opozita ka numër më të vogël të deputetëve. Përveç këtyre që i cekëm, në Kuvend kemi edhe disa komisione që janë të ndara nga njëra-tjetra dhe kanë funksione të ndryshme. Kemi komisione të përhershme siç është komisioni për financa. Po ashtu, kemi komisione funksionale dhe komisione të përkohshme. Ne sot mësuam po ashtu edhe për deputetët. Çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të kandidoj për deputet, ku mund të jetë deputet i pavarur ose mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike. Gjatë kohës së kandidimit, kandidatët për deputetë shpalosin programin e tyre ku mundohen ta bindin popullin që ta votojnë. Ne mësuam se vendet demokratike kanë edhe zgjedhje edhe institucione demokratike.



Deputetët e përfaqësojnë popullin në Kuvend



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë